



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

PROCESVERBAL Nga Diskutimi Publik

I Mbajtur me banorët e lagjeve “Qendra” 1 dhe “Qendra” 2

Datë: 14.03.2022

Me fillim në ora 10:00h

Vendi: Salla Salla e Kuvendit të Komunës

Prezenca e pjesëmarrësve: Ekziston lista e bashkangjitur

Tema: Draft Plani Harta Zonale Komunale Mitrovica Jugore 2021-2029.

Takimin e shpalli të hapur z. Edison Tërnavë. Ark - Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, i cili pasi i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit në këtë diskutim publik, tha se ky është një dokument i rëndësishëm së veçantë dhe ka për qëllim që t'i japë zgjidhje zhvillimit të qëndrueshëm dhe regjenerim të qytetit, andaj i inkurajon të gjithë qytetarët që të kontribuojnë në këtë drejtim përmes dhënies së vërejtjeve dhe propozimeve gjër në hartimin final të dokumentit Harta Zonale Komunale.

Më pas fjalën hyrëse i'a kaloi Shefit të Sektorit për Planifikim në kuadër të DPU-së z. Nexhmi Hasani, në cilësi të Koordinatorit të procesit për Hartimin e Hartës Zonale të Komunës.

Pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falenderoi për prezencën e tyre në nivel, në vazhdim të fjalës së tij Nexhmi Hasani tha se organizimi i diskutimit publik është në interesin tuaj mirëpo për këtë na obligon edhe Ligji Nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinor dhe qëllimi i këtij takimi është që qytetarët të informohen më hollësisht me procesin e hartimit të HZK-së, dhe siç e parasheh edhe Ligji ky dokument është në interes të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor në tërë territorin e komunës, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit sa më racional të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Janë dy nivele të Planifikimit, Niveli Qendror dhe Niveli Lokal.

-Planifikimi në nivel qendror parasheh Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, si dhe Planin Hapësinor për Zona të Veçanta,

Plani lokal përfshinë Planin Zhvillimor të Komunës, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishe,

Plani Zhvillimor komunal është dokument multisektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social, hapësinor etj për një periudhë të ardhshme 8 (tetë) vjeçare.

Harta Zonale e Komunës është dokument multisektorial që përmes grafikoneve, hartave, fotove dhe pjesës tekstuale, përcakton llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimt, ndërsa

Planet Rregulluese të hollësishe përcaktojnë kushtet e rregullimit të hapësirave për zonat urbane dhe rurale.

Gjërë me tani hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor është bërë, sipas standardeve të vendeve të tjera, pasi që ishte mungesë e rregullatives ligjore, për normat teknike të planifikimit hapësinor, kurse tani i mkemi edhe normat teknike, Udhëzimet Administrative për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Meqenëse hartimi i tyre kërkon një punë të madhe dhe ç'është më kryesorja është në pyetje ana, ne kemi përzgjedhë një Kompani hartuese që gëzon një përvojë në fushën e planifikimit, sipas Ligjit të ri të Ndërtimit siç është Kompania INS-i, e cila deri me tani ka përfunduar një numër të madh të Planeve hapësinore dhe hartave zonale nëpër disa komuna të Kosovës.

Përveç që u njoftuan me draftin e këtij dokumenti, qytetarët që moren pjesë në këtë takim u angazhuan që t'i japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për HZK-në, e sidomos u shprehën shqetësimet e tyre lidhur me ndërtime të larta, mungesën e hapësirave gjelbra.

Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm do të vazhdojë të organizojë diskutime të kështilla edhe në ditët në vijim, kurse qytetarët janë ata që komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet e tyre, mund t'i paraqesin edhe përmes Ueb faqes zyrtare të komunës, apo edhe drejtëpërdrejtë në zyrën e Sektorit për Planifikim tek zyrtari përgjegjës z. Nexhmi Hasani.

Tani i'a kaloj fjalën përfaqësuesit të kompanisë INSI, që të bëjë një prezantim, se deri ku kanë arritur në procesin e hartimit të dokumentit të HZK.

Ismajl Baftijari, Së pari ju përshendes të gjithëve dhe njëherit ju falenderoj për pjesëmarrje në këtë diskutim. Janë bërë disa hapa të punës në procesin e hartimit të Draft dokumentit të Hartes Zonale Komunale, për çka këtu para jush do ta bëjmë një prezantim, mirëpo ashtu siç e parasheh Ligji përkatës dhe Udhëzimet Administrative, bartës i procesit dhe i përgjegjësisë është secila komunë dhe më konkretisht Drejtorja për Planifikim, andaj ne si Kompani jemi të autorizuar që t'i shfrytëzojmë maksimalisht kapacitetin dhe përvojat tona në mënyrë që hartimi i dokumentit të jetë sa më profesional e që e gjithë kjo është në interes të qytetarëve sepse ky dokument përfshinë tërë territorin e komunës. Andaj edhe një herë po e theksoj se jemi sot këtu për të marrë vërejtjet e juaja, duke na parashtruar pyetje, e pastaj të njëjtat do të shqyrtojmë një nga një me qëllim që para finalizimit të draftit të dalim me një dokument i cili do të jetë i zbatueshëm për 8 (tetë) vitet e ardhshme.

Pas përfundimit të prezantimit, të pranishmeve i'u tha se tani fjala është për juve që të parashtroni pyetje dhe mundësisht të fokusoheni për lagjet për të cilat është organizuar ky diskutim publik, procesi është transparent, e hapim diskutimin.

Fidan Mehmeti- pyeti se a është diskutimi i sotëm vetëm për Lagjet Qendra 1 dhe Qendra 2 po pikërisht pasi që takimet ardhshme takimet i kemi me lagjet tjera.

Nexhip Osmani- Prona ime është në afërsi të objektit të stacionit policor, jemi të interesuar për ndërtim por i kemi disa pengesa rreth një prone e cila është nën menaxhim të APS-ë, dhe po na kontestohet e drejta për të lidhë marrëveshje me ndonjë operator dhe sa jemi në dijeni aty koeficienti i ndërtimit është 2.2.

E kjo na e sillni në formë të shkruar shqetësimin e juaj dhe ne do t'a shqyrtojmë dhe do të merrni përgjigje.

Nexhmedin Spahiu- afër shtëpisë së Xhafer Deves, është një objekt i rrenuar dhe duke qendruar ashtu si germadhë, është shndërru në vend mbeturinash, andaj propozoj që ky objekt të shpronësohet nga komuna dhe urbanizmi duhet ta ketë parasysh që ky vend të shndërrohet në hapësirë gjelbra dhe parqe. Në lagjen qendra nuk ka as edhe një vend për ndërtim të lartë, as nuk ka rrugë, oborri im kufizohet me objektin e shkollës fillore "Bedri Gjinaj".

Fadil Salihu- sa është koeficienti të Xhamija "Haxhi Veseli", deri të BIK-u është me planin qendra dhe ka koeficient më të lartë.

Mevlude Skuroshi- pyetje rreth draftit, sugjerimet e mia janë për shtigje të biçikletave, me u ndal ndërtime të larta dhe me u vendosë një standard për ndërtime të larta, me u shtue hapësira të gjelbra, mos me u rrenu ndërtime me vlerë, mos me u pre asnjë dru më i vjetër se 10 (dhjetë) vjetë, mos me u leju ndërtime në qendër të qytetit dhe rreth lumit ibër dhe me pas me tepër parkingje.

Uran Boshnjaku- lagja ka nevojë për zgjerim, në rastë se lejohet rritja e koeficientit të ndërtimit.

Izet Feka- kërkohet të na lejohet me u ndërtu një objekt me kete më të larta.

Milaim Ramadani- lagja 2 Korriku, kur do të intervenohet në rregullimin e lumit "Sitnica" për me u mbrojtë banoret nga rreziku i vërshimeve, të mos lejohen ndërtime në afërsi të lumit dhe çka është sipas planit për me u ba deri në përfundimin e kejit të lumit.

Asllan Sejdiu-sa është koeficienti i ndërtimit dhe a paraqet pengesë objekti i kishës për me u rritë koeficienti në lagjen qendra 2.

Perihan Hoti- kemi kërkesë për ngritje të koeficientit, në Rrugën “Ethem Prekazi” gjendemi afër xhamisë së “Haxhi Veseli”, - gori mahalla.

Jeton Shala- Harta zonale mbishtresore, kush i ka përcaktu dhe në cilat pjesë të qytetit.

Lulzim Hoti- “7 Arte”, që këto zona të kenë edhe hapësira përcjellëse , me i kushtu rendësi interesit publik dhe a është mendu për më shumë qerdhe dhe mungon teatri dhe biblioteka.

Kushtrim Januzi- a është parapa se ku kanë me u vendosë kontejnerët.

Muharrem Vojvoda- pyetje deri ku llogaritemi si Qendra, jemi në Fidanishte.

Xhavit Beka- a ka mundësi me u ndërru koeficienti dhe çka do të bëhët në atë lagje.

Sali Rexhepi- kemi problem me rrjedhje të kanalizimit.

Xhylishah Cena- çka është paraparë me u ndërtu tek ish shkolla e uljt e muzikës.

Pasi që nuk kishte pyetje tjera nga të pranishmit, u vendos që diskutimi të mbyllet, duke i njoftuar se javen e ardhshme vazhdojmë me banorët e lagjeve tjera.

Përfundoj në ora 12,30h.

Procesmbajtësi

Xhevdet Aruqaj
Zyrtarë Ligjorë



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DISKUTIM PUBLIK

Draft plani-Harta Zonale Komunale

Me banorët e lagjes: “Qendra 1” dhe “Qendra 2”

Data: 14.03.2022

LISTA E PJESËMARRËSVE

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. Telefonit	Nënshkrimi
1	Shemse-din Jusufin	Mitrovicë	044-148 045	
2	ARMEND HAKAZ	MITROVICË	049-201007	
3	IBRAHIM MRAHUVI			
4	FLORENT ARRA SHI	MITROVICA	044 224582	
5	FLORENT HAXHIHETI	MITROVICË	049 133033	
6	Gazet Mehmeti	Skopje	045 114 608	
7	Rushid Shyti		044, 895 082	

8	ARDIAN SEBATHIRI	КЕДИ МАДН	045/421-354	
9	Syufenir Ademi-Jodri	Митровице	044/969628	
10	SAVVI DEAVA	MITROVICE	044-852-646	
11	Mehmet Bogdan	D.SRP.	049-540-612	
12	SHANSEDIN BAKRAMI	D.P.U.	049/467605	
13	SEBASTIAN TAHERI	DPU	049/1509-622	
14	Besira Shyla	DPU	044/164-186	
15	Elmedina Bajrami	SNPKOC	049/199-722	
16	SHHRETE PEÇI	KRBALIZËM	049/685-588	
17	ALBERT AKILZAJ	MITROVICE	049-611-110	
18	Kushtrim Januzi	—	049-869 741	
19	FRASIR BUKARQOL	MITROVICE	049/1710,174	
20	Gjuri Klinau	KIBRISË	049/174-911	
21	HAJAN MLINAKU	—	049/636-606	
22	VENERA GORRA	PRISTINE	044/190057	
23	VAHON GERUZH	INSA-PRISTINE	044555382	
24	ASRETA SARA	MINUCE/SS	049 400 667	
25	MUHAMED VOJVOĐA	MITROVICE	049 587034	
26	Суплиша Cerar	MITROVICA	—	
27	Melinda Spuroski	Zhabar	mekaroshi@gmail.com	
28	Genti Behramaj	MITROVICE	genti.behramaj@gmail.com	
29	Valent Jbishi	BAGDAD	Sido - vali@yahoo.com	
30	Idall Boshnjaku	MITROVICA	—	
31	Yehi Nikisi Penco Gombog	MITROVICE	049-245 689	
32	KORBA KHINEVCI	MITROVICA	045-101-619	
33	Hajrudin Horani	MITROVICA	049-734-489	
34	MASSER DSAVVI	MITROVICA	049127777	

35	WEYHIP OSMANLI'	049 517 477	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
36	ARDIAN SHERBECI'	049 772 585	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
37	EVER SHERBECI'	049 317 777	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
38	LULZIM HOTI	049 211 771	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
39	Bushon Ismajer	049 119 858	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
40	MILNIN ARMANOVI'	044-746-289	- 71 -	<i>[Signature]</i>
41	ARBËR HOTI	048-337798	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
42	Rebnit Imeri	049 541 807	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
43	BETAR MARGIOLÉ	049-457-056	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
44	Flanije Paetari	044-124-244	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
45	PERHATA HOTI	049-849-785	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
46	Shymel Hoti	049-849-788	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
47	Wajed Gashi	049-147-267	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
48	Arban Fida	049-262-450	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
49	MYSECRET OSHCANI'	044-909-342	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
50	SADIK DELICÉ	044-613-913	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
51	FANIS SANKU	045-881-560	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
52	BEQID SALTHU	049-467-564	MITHAN	<i>[Signature]</i>
53	SHERIF DAKAY	049-277-822	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
54	Fidan Mehmeti	049 1919 88	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
55	Xhavik Beba	049 300 747	Mitrovicé	Xh.Beba
56	Arban Peçi	049-88-44-11	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
57	JETON SHAMA	049/174742	MITROVICÉ	<i>[Signature]</i>
58	SHUAB GASHI	049/595-355	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
59	Mysan Oshlomi	049/4561064	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
60	IZET FEHA	1003940568	Mitrovicé	<i>[Signature]</i>
61	Xhendek Musogj		Urbanizem	<i>[Signature]</i>